



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:226706

Datë: 15.11.2023

Numri i dokumentit: 04925549

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.71/22

GJYKATA THEMELORE PEJË, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Leon Përlaska me procesmbajtëse Shpresa Kërnye në çështjen penale kundër të pandehurit F. R. nga fshati Istog, komuna e Pejës, për shkak të veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 lidhur me par.3 dhe nënpar.3.2 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1301/2021 të datës 05.10.2021, në seancën publike të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 23.10.2023 në prezencë të prokurorit së shtetit Dorjan Juniku dhe të pandehurit F. R. me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av.Valdrin Bajraktari të njëjtën ditë mori dhe shpalli ndërsa me datë 30.10.2023 e përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri:

F. R., i lindur me . në fsh. I., K-Pejë, me banim ne fsh S., K-Istog, ne rr.”D. i B.” i biri i Shabanit, i pa punë, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. ...., i nacionalitetit Shqiptar, shtetas i R. Kosovës.

SHPALLËT FAJTOR

Për shkak se :

Me dt. 11.07.2021 rreth orës 08:20, në fsh. Sh., pikërisht ne vendin e quajtur P. i J., paralele 11, pjesë e parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, pret tre trungje, të llojit te breut, me vëllim te përgjithshëm 1.34m<sup>3</sup> në at mënyrë që, i pandehuri pasi fillimisht i pret drunjtë e lartcekur dhe të

njëjtat i ngarkon në automjetin e tij të llojit P. – C. B., ku gjatë bartjes së tyre haset te laura, nga patrulla e stacionit kufitar, te cilët automjetin dhe masën drusore e sekuestrojnë.

- me çka ka kryer veprën penale Vjedhja e pyllit nga neni 349 par. 1 e lidhur me par.3 dhe nënpar.3.2 të KPRK-së.

Prandaj në kuptim të nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 38, 39, 40, 42, 46, 48, 49,69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ( 06/L-074):

### GJYKON

Të pandehurit F. R. i shqipton:

- DËNIM ME BURGIM TË KUSHTËZUAR ne kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari nuk do të kryej vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, qe do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- Obligohet i dënuari qe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.

### ARSYETIM

- Historiku i çështjes dhe vendimi ne lidhje me fajësinë;

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm me datë 05.10.2021 pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1301/2021 kundër të pandehurit F. R. nga fshati Istog, komuna e Pejës, për shkak të veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 lidhur me par.3 dhe nënpar.3.2 të KPRK-së.

Kjo gjykatë me datë 23.10.2023 e mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor në të cilën prezantuan prokurori i shtetit Dorjan Juniku i pandehuri F. R. me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av.Valdrin Bajraktari, në të cilën seancë i pandehuri u deklarua se e pranon fajësinë për veprën penale qe i vihen në barrë.

Pas marrjes së mendimit të prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të të pandehurit, në kuptim të nenit 322 par.1 dhe 4 të KPPRK-së, gjykata vendosi që të aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri, pasi që është e qartë se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe provat e pranueshme që e mbështesin aktakuzën dhe se aktakuza nuk përmban shkelje të qarta ligjore ose gabime faktike.

Pas aprovimit të pranimin të fajësisë nga ana e gjykatës, prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare deklaroi “ Pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit F. R., gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor kryesor, u vërtetua përtej dyshimit mirë të bazuar se i njëjti e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet dhe kjo u vërtetua nga procesverbali mbi konfiskimin e sortimenteve pyjore me nr..... lëshuar nga DAPK Bjeshkët e Nemuna në Pejë, nga foto dokumentacioni shkresave të lëndës ku shihet vetura PIK AP, veturë e bartjes në të cilën kishte të ngarkuara trungje të llojit me vëllim prej 1.34 m<sup>3</sup> si dhe foto dokumentacioni vendi të ngjarjes ku shihen cunga të mbetur nga trungjet të cilat i kishte prerë këtu i pandehuri F.. Andaj, nga sa u tha në lartë mbes në tërësi pranë aktakuzës dhe kualifikimit juridik të saj ashtu që nga gjykata kërkoj që të akuzuarin ta shpall fajtor, ta dënoj sipas ligjit si dhe ta obligoj në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale ndërsa me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit pranimin e fajësisë ta vlerësoj si rrethanë lehtësuese ”.

Mbrojtësi i të pandehurit av.Valdrin Bajraktari në fjalën përfundimtare deklaroi " Pas pranimin të fajësisë nga ana e të mbrojturit tim të cilin e pranoj me vullnetin e tij të plotë, andaj i propozoj gjykatës që gjatë shqiptimit të dënimit si rrethanë lehtësuese ndaj të mbrojturit tim të merr pranimin e fajësisë, premtimin se në të ardhmen nuk do ti përsëris veprimet e tilla si dhe gjendjen e dobët ekonomike i cili është përfitues i skemës sociale, andaj i propozoj që të shqiptoj një nga dënimet alternative ndaj të mbrojturit tim".

I pandehuri në fjalën përfundimtare deklaroi " pajtohem me mbrojtësin tim, më vjen shumë keq që ka ndodh ky rast, i kërkoj falje të gjithëve në gjykatë".

- Vendimi lidhur me dënimin;

Gjykata kur vendosi të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në dispozitat 38, 39, 40, 42, 46, 48, 49, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ( 06/L-074) dhe atë duke vlerësuar rrethanat lehtësues dhe renduese të çështjes.

Për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehurit ligjvënësi ka paraparë mundësin e shqiptimit të dënimit me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit, e në këtë rast gjykata ndaj të pandehurit vendosi që të shqiptoj dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohen nëse i dënuari nuk do të kryej vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej një (1) viti, që do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

Përcaktimi i dënimit me burgim prej 6 (gjashtë) muajsh u bë dukë e filluar matjen e dënimit nga pikënisja e dënimit, që sipas praktikës gjyqësore dhe udhëzuesit të Gjykatës Supreme, pikënisje është pika e mesme e minimumit dhe maksimumit të dënimit për veprën penale përkatëse. Në këtë rast pikë e mesme e dënimit për veprën penale të kryer nga i pandehuri është dënim me burgim prej gjashtë muaj.

Pastaj, duke vlerësuar rrethanat renduese dhe lehtësuese të rastit, duke bërë peshimin e tyre si dhe duke aplikuar dispozitat ligjore përkatëse për matjen e dënimit, gjykata vendosi për dënimin me burgim të shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke i analizuar faktet e çështjes, gjykata erdhi në përfundim se në lidhje me të pandehurin nuk kemi fare rrethana renduese, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata e gjeti pranimin e fajësisë të bërë në seancën e shqyrtimit fillestar dhe keqardhjen e shfaqur me rastin e pranimit të fajësisë, ku duke u nisur nga këto rrethana dhe në kuptim të nenit 38 dhe 42 të KPRK-së gjykata vendosi që ndaj të pandehurit të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kur u vendos për kushtëzimin ekzekutimit të dënimit me burgim gjykata u bazua në nenin 46, 48 par.1 dhe 2 dhe 49 par.1 dhe 3 të KPRK-së.

Gjykata vlerësoj se me shqiptimin e dënimit më kusht ndaj të pandehurit do të arrihet të realizohet në tërësi qëllimi i dënimit, pasi që ky dënim do të ndikoj në rehabilitimin e të pandehurit, në

parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale dhe në mënyrë të arsyeshme shpreh gjykimin shoqëror për veprimet e kryerësit . Tërheqja e vërejtjes të pandehurit se nëse në periudhën verifikuese prej një viti do të kryej vepër tjetër penale ndaj tij do ekzekutohet dënimi me burgim si në dispozitiv të aktgjykimit, është një paralajmërim serioz që të parandalojë të pandehurin në kryerjen e veprave penale në të ardhmen.

Gjykata e shqiptoj dënimin më kusht në përputhje me nenin 49 par.1 të KPRK-së ku thuhet “Dënimi me kusht mund t’i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në pesë (5) vjet”, e në këtë rast siç u përshkrua me lartë për veprën penale që është shpallur fajtor i pandehuri është parapare mundësia e shqiptimit të dënimit me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhshmëri të plotë me qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe se ky dënim do të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale të ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer nga të pandehurit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor u mor në kuptim nenit 450 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 453 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, u mor në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Andaj, duke u mbështetur në fakte e parashtruara dhe dispozitat ligjore nga neni 364 dhe 369 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### GJYKATA THEMELORE PEJË

Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Penal

P.nr.71/22, me datë 30.10.2023

Procesmbajtësja

Shpresa Kërnje

Gjyqtari i vetëm gjykues

Leon Përlaska

#### KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.